



Pranuar / Dorezuar Priljena / Predato Received / Delivered	25.04.23	3	viti god year
Organ / Shënia Organ / Jednica Org. / Unit	SKM/SHCK	3814/2023	Sivna Kolicina Quantity
			113



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.494/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari- kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë dhe Kaltrina Avdullahi-Prenaj Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesën me numër A.nr.494/2023 të datës 13.03.2023, të ankuesit _____ kundër organit të punësimit/Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike "vlerësim i rezultateve në punë", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 25.04.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr. 494/2023 të datës 13.03.2023, të parashtruar nga ankuesi
- II. Çështja bije në kompetencë të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

A r s y e t i m

Ankuesi _____ sipas Vendimit me numër Nr.98/09 të datës 23.11.2009 është emëruar Ministër Këshilltar në misionin diplomatik në Ankara/Republika e Turqisë ndërsa sipas Vendimit me Nr. Ref:020/2014 të datës 10.01.2014 të Ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme për nevoja të institucionit kthehet të shërbejë në njërin prej Departamenteve të Ministrisë së Punëve të Jashtme nga data 01.03.2014. Pas përfundimit të misionit diplomatik ankuesit i është lëshuar Akt Emërimi me numër 176 më datë 18.04.2016 për pozitën „Drejtor i Departamentit për Diplomaci Ekonomike“, ndërsa sipas Dekretit me numër 52/2019 të datës 12.02.2019 të Presidentit të Republikës së Kosovës, i njëjti është emëruar Ambasador/Shef i Misionit Diplomatik të Republikës së Kosovës në Republikën Popullore të Bangladeshit.

Ministrja e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës ka bërë vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin për vitin 2022, ndërsa ankuesi i pakënaqur me këtë vlerësim më datë 13.03.2023, ka parashtruar ankesë me numër protokolli 2598/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 24.03.2023 ankesën e ankuesit e ka proceduar tek Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ndërsa më datë 04.04.2023 dhe 06.04.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me provat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave nga administrimi i shkresave të lëndës ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, *nuk është kompetent* për të vendosur për ankesën me numër A.nr.494/2023 të datës 13.03.2023 të parashtruar nga ankuesi *sepse:*

Bazuar në provat e lëndës rezulton se ankuesi sipas Dekretit me numër 52/2019 të datës 12.02.2019 të Presidentit të Republikës së Kosovës, me datë 12.02.2019 është emëruar Ambasador/Shef i Misionit Diplomatik të Republikës së Kosovës në Republikën Popullore të Bangladeshit, në pajtim me nenin 84 paragrafi 4, 10 dhe 25 të Kushtetutës së Kosovës, si dhe legjislacionin e aplikueshëm për Shërbimin e Jashtëm, përkatësisht nenin 7 të Ligjit Nr.03/044 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik, i ndryshuar me nenin 2 të Ligjit Nr.03/L-207 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr.03/L-044 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se: *7.1. Emërimi i Ambasadorëve dhe Shefave të Misioneve bëhet nga Presidenti i Republikës së Kosovës me dekret.*

Rrjedhimisht, me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 3 paragrafi 1 është përcaktuar se: *1. Ky ligj nuk zbatohet për: 1.1. funksionarët publikë; 1.2. funksionarët publikë me status të veçantë, ndërsa me paragrafin 2 të këtij neni është përcaktuar se: 2. Funksionarë publikë, në kuptimin e nën paragrafit 1.1 të këtij neni, janë: 2.1. të zgjedhurit; 2.2. anëtarët e Qeverisë dhe zëvendësit e tyre; 2.3. funksionarët e emëruar nga Kuvendi apo nga Presidenti i Republikës dhe titullarët apo anëtarët e organeve drejtuese kolegjiale të institucioneve të pavarura dhe të agjencive të pavarura, nga rrjedh se të emëruarit nga Presidenti i Republikës së Kosovës, siç është rasti i ankuesit kanë statusin e funksionarit publikë dhe si rrjedhojë për shkak të këtij statusi janë të përjashtuar nga fusha e zbatimit të Ligjit për Zyrtarët Publikë.*

Andaj, bazuar në dispozitat ligjore të cekura si me lartë dhe duke marr parasysh se ankuesi me Dekretin me numër 52/2019 të datës 13.03.2023 të Presidentit të Republikës së Kosovës, është i emëruar si ambasador dhe se objekti ankimor ka të bëjë me vlerësimin e rezultateve të punës si pasojë e ushtrimit të këtij funksioni, Kolegji i Këshillit konstaton se ankuesi gjatë periudhës së ushtrimit të funksionit të ambasadorit në Republikën e Bangladeshit nuk e ka statusin e nëpunësit civil, ngase i njëjti konsiderohet funksionar publikë për aq kohë sa Dekreti me numër 52/2019 i datës 13.03.2023 i Presidentit është në fuqi, dhe si rrjedhojë Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës gjatë ekzistimit të kësaj



gjendje statusore nuk ka kompetencë për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesës me numër A.nr. 494/2023 të datës 13.03.2023, sepse Këshilli sipas nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është kompetent të shqyrtoj dhe të vendos vetëm për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për praninë në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kolegji i Këshillit në këtë kontekst thekson faktin se në momentin që ankuesi lirohet nga detyra apo i përfundon mandati i funksionarit publikë i emëruar sipas dekretit presidencial, të njëjtit i lindin të drejtat e parashikuara me legjislacionin e shërbimit civil, pasi që ankuesi para se të emërohej ambasador, sipas Aktit të Emërimit me numër 176 të datës 18.04.2016 kishte statusin e nëpunësit civil që tani përcaktohet me nenin 2 paragraf 1 dhe 2 nën paragrafi 2.1 ndërlidhur me nenin 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Kështu që pas konstatimit se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr.494/2023 të datës 13.03.2023, për shkak të statusit aktual të funksionarit publikë të ankuesit, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në Aktgjykimin në rastin nr. KI214/21 të datës 06.01.2023 të Gjykatës Kushtetuese, si dhe nenin 75 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, udhëzon palën ankuese për ushtrimin e mjeteve juridike në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Për sa më sipër dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.494/2023

Kaltrina Avdullahi Prenaj

[Signature]
Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

[Signature]
Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punës së Jashtme dhe të Diasporës;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punës së Jashtme dhe të Diasporës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së